



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 68/16
Prishtinë, më 28.9.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Shqipe Pantina, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontić dhe Shukri Buja.

Pjesëmarrës të ftuar: Mentor Shala, Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: monitorues nga KDI, Kadri Jogiste dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Kransiqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.9.2016;
3. Shqyrtimi i Kërkesës së Radiotelevizionit të Kosovës për mjete shtesë buxhetore për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-110 për kamatvonesën në transaksionet tregtare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.9.2016;

Kryetari – konstatoi se procesverbali i datës 14.9.2016 miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Kërkesës së Radiotelevizionit të Kosovës për mjete shtesë buxhetore për vitin 2016;

Kryetari – theksoi se kemi pranuar një kërkesë të RTK-së për mjete buxhetore shtesë. Ajo që është më interes është kërkesa lidhur me blerjen e të drejtave televizive për transmetimin e ndeshjeve të përfaqësueses së Kosovës në Kapionatin Botëror 2018, për shkak se këto shpenzime nuk ka mundur të planifikohen, për shkak të anëtarimit të Kosovës në UEFA dhe FIFA, në ndërkohë.

Mentor Shala - theksoi se kërkesat e paraqitura paraqesin situatën financiare të RTK-së por edhe disa nevoja shtesë që janë paraqitur dhe të cilat nuk i kemi mundur të parashikojmë me buxhet. Janë disa ngjarje sportive që janë më rendësi nacionale siç është anëtarësimi i Kosovës në UEFA dhe FIFA, që nuk kemi mundur ti planifikojmë paraprakisht dhe është problem të parashikohet për sport për shkak se çdo projekt ndryshon shifrat dhe të drejtat televizive të transmetimit të ndeshjes të ndryshme. Siç është rasti i Olimpiadës kur para katë viteve i kemi blerë të drejtat televizive prej 25,000 euro dhe ka qenë një situatë tjetër, pasi që të drejtat për territorin e Kosovës i ka pas RTS, pasi që Kosova nuk ka qenë pjesë e komunitetit olimpiq dhe normalisht se ata e caktojnë çmimin dhe ne prej ofertës që e kemi pas prej 150,000 euro, kemi rënë në 60,000 euro në kuadër të programit sportiv. Situata tjetër ka të bëjë me pjesëmarrjen e Kosovës në kualifikueset e Kampionatit Botëror 2018 dhe kontrata është 130,000 euro që i kemi bashkangjitur së bashku me faturat. Pastaj është qështja e realizimit të ndeshjeve kur Kosova është vendase dhe për ato faurat vijnë më vonë sa lojë që do të luhen që janë jashtëzakonisht të shtrejtja. E fundit që dje është mbyllur ka të bëjë me kualifikueset evropiane 2020 edhe kualifikueset e kampionatit botëror 2022 dhe ne kemi aplikuar për shkak se jo vetëm që e kemi obligim ligjor por janë ngjarje të rëndësishme sportive.

Shqipe Pantina - unë e kuptoj se RTK-ja në bazë të ligjit e ka obligim mbulimin e disa prej aktiviteteve sportive, sidomos ato që kanë të bëjnë me kampionatet evropiane dhe botërore ku merr pjesë edhe Kosova, por për mua është totalisht e papranueshme që gati 13 përqind e buxhetit me shku vetëm në sport kur ka mungesë të emisioneve tjera me interes të publikut, siç janë emisionet arsimore, edukative dhe dokumentar të ndryshëm, sepse sporti për mua më shumë është argëtim dhe biznes. Prandaj, për mua është e papranueshme me shku kaq shumë para në emisione sportive. E kam të qartë që RTK-ja duhet me i mbuluar kampionatet sportive, por pse p.sh. duhet me u mbulue Ligën e Zvicrës? Pse patjetër licenca është dashtë me u marr prej RTS, kur ka mundur me negociuar me ndonjë televizion tjetër si p.sh Digjitalb, TVSH-në apo ndonjë televizion tjetër? Duke qenë RTK anëtare e EBU-se, cilat janë përparësitë e të paguarit të anëtarësimit kur ti nuk mundesh me pas qasje në emisione të tilla, të cilat nuk prodhohen nga një televizion lokal, në këtë rast as nga RTK-ja, por duhet që të drejtat televizive të blihen? Qështja tjetër më serioze është mungesa e një planit nga RTK për shlyrjen e borxheve të krijuara.

Kryetari - konsideroj që ngjarja me e madhe sportive, por edhe politike për Kosovën ka qenë pranimi i saj në UEFA dhe në FIFA. Prezantimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare nuk është vetëm argëtim dhe konsideroj që është në interes publik transmetimi i futbollit, të paktën ndeshjet e reprezentacionit të Kosovës në garat e kampionatit botëror 2018.

Besa Gaxheri - duke pasur parasysh arsyeshmerinë e transmetimit të ngjarjeve sportive ne nuk mundemi pa e mbulue transmetimin e ndeshjeve të reprezentacionit të Kosovës edhe pse unë nuk jam fanse e futbollit, megjithatë ne si shtet patëm rastin me qenë anëtare te këtyre organizatave botërore të sportit. Prapëseprapë, unë nuk mundem pa e thënë që RTK duhet kursyer para, dhe të keni parasysh programet e sakta numrin e punëtorëve, shujtat e gjëra tjera, sepse kur vini këtu për të planifikuar buxhetin vitit 2017, kemi me i shikuar një nga një.

Bardhyl Meta – pyeti drejtorin me këtë shumë të mjeteve apo heqen edhe disa borxhe të vjetra?

Mentor Shala – ne listën e sportit janë edhe disa borxhe që janë paguar ne ndërkohe. Këtë listë e kemi dorëzuar para një jave dhe në ndërkohë kemi paguar mjete. Këtu te Olimpiada e kemi paguar dhe është dashtë me i marre parat brenda buxhetit, sepse nuk i kemi pas të planifikuara. Kemi hequr edhe Ligën e Kampioneve dhe e kemi paguar 90,000 euro si borxh i vjetër edhe kanë mbetur 70,000 euro.

Bardhyl Meta – unë jam për aprovimin e kësaj kërkesa për sport, por kishte qenë mirë komisioni për buxhet dhe financa me i sugjeru drejtorit gjeneral që shujtat të hiqen në të ardhmen e afërt.

Safete Hadërgjonaj - zakonisht kur kërkesa të tilla na vijnë ne komision nuk janë te mira,sepse duhet te përballemi me arsyeshmërinë e ndarjes se mjeteve. Mirëpo kësaj radhe një kërkesë e tillë, mendojë që domosdo duhet t'i gjejmë një zgjidhje, meqenëse është fjala për transmetimin e kampionatit botëror 2018 dhe ndeshjeve të përfaqësueses së Kosovës. Ajo që për mua është shqetësuese është fakti që ne si Kuvend ende nuk kemi bërë zgjidhjen për mënyrën e financimit te RTK-së. Ne kemi pasur një grup punues të përbashkët me komisionin për administratë publike, qeverisje lokale dhe media dhe ai grup punues nuk ka prodhuar efekt. Ta bëjmë ligjin dhe ta përcaktojmë mënyrën e financimit të RTK-së sepse me një gjendje të tillë çfarë jemi do ta kemi problem gjatë vitit të ardhshëm.

Enver Hoti - sa ju përket kërkesave që i keni adresua ne mënyrë tabelore, ju e keni një kërkesë që rezulton një shumë mbi 3 milion euro, ndërsa arsyetimi është vetëm për tabelën ku paraqiten ngjarjet sportive. Ne jemi të kënaqur për prezantimin e rinisë sonë në ngjarje të ndryshme edhe sportive, por mjetet duhet të jenë të planifikuara. Ndërsa në kërkesën tuaj janë përcjell disa borxhe, që nuk keni dhënë asnjë sqarim. Shpenzimet vjetore janë të larta dhe të gjitha lidhen me numrin e madh të punëtorëve dhe ju vazhdimisht e rritni numrin e punëtorëve në mënyra të ndryshme edhe me kontrata mbi vepër. Unë jam për vlerësim pozitiv vetëm për pjesën sportive, ndërsa pjesa tjetër e kërkesave duhet te refuzohet në mënyrë unanime nga i gjithë komisioni.

Kryetari – propozojë që t'i bëjmë një rekomandim Ministrisë së Financave që të ndajë një shumë RTK-së deri në 400,000 euro për mundësinë e transmetimit të ndeshjeve sportive, duke u bazuar në nenin 14 paragrafi 2 të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me tetë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomadohet Ministrisë së Financave, që në pajtim me nenin 14, paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me rastin e autorizimit të ndarjeve prej një organizate në një organizatë tjetër buxhetore, të autorizojë ndarjen e mjeteve shtesë buxhetore për Organizatën Buxhetore - Radiotelevizioni i Kosovës, në shumë prej 400,000 (katërqind mijë) euro, për pagesën e shpenzimeve për “Transmetimin e ndeshjeve kualifikuese të Kampionatit Botëror 2018”.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L- 066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

Kryetari - në grupin punues kemi shqyrtuar Projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, të cilët kanë dhënë arsyetimet e veta, dhe jemi bindur se duhet ta mbështesim projektligjin me një ndryshim që e ka të bëjë me amendamentin 12 të komisionit funksional, respektivisht me për qejën e paragrafit 4, që ka të bëjë me propozimin për kompensimin deri në 50% të pagës bazë për praktikantët dhe kemi vlerësuar se nëse mbetet kjo atëherë ndërmarrësit privat nuk marrin me praktikant se duhet me i pague detyrimisht në bazë të ligjit.

Shqipe Pantina - unë kam punuar në një projekt të Komisionit Evropian për shkollat profesionale, dhe me rregulla, praktika nuk paguhet. Por janë disa të drejta tjera, si pagesa e sigurimit shëndetësor, sigurimet që lidhen me profesionet që munden me pas rrezikshmëri, e që duhet me i gëzue praktikanti.

Kryetari – sqaroj se në bazë të paragrafit 4 të nenit 12 të projektligjit, praktikanti gjatë realizimit të praktikës profesionale, mundë ti jepet një kompensim siç përcaktohet nga institucionet apo organizatat ku mbahet praktika profesionale. Por në si grup punues, kemi rekomanduar që propozimi i komisionit funksional që ka të bëjë me caktimin me ligj të kompensimit prej 50% të pagës bazë, të hiqet dhe të mbetet që institucioni dhe organizata të rregullojë qështjen e pagesë së praktikantëve në bazë të nevojave dhe mundësive buxhetore.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rekomandimit të grupit punues, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni për Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 12, paragrafi 4, për të cilin rekomadohet që të fshihet dhe të mbetet teksti siç është në projektligj.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryetari - unë e kam takuar Ministrin e Shëndetësisë dhe kemi diskutuar për këtë qështje dhe kjo normalisht që paraqet bazën e shëndetësisë në Kosovë, por ka kosto buxhetore.

Bali Muharremaj – ne si grup punues jemi takuar dhe në takim kanë marrë pjesë edhe zv.ministri i financave dhe përfaqësues të ministrisë së shëndetësisë. Projektligji ka një kosto buxhetore shtesë prej 15,500 euro që është vlerësuar se është e përballueshme. Problemi është tek amendamentet e komisionit funksional që kanë një kosto shtesë mbi 30 milion euro, dhe atë 15 milion euro janë investime kapitale dhe 15 milion euro shpenzime rrjedhëse. Në bisedë me zv.ministrin e financave është thënë se brenda tri viteve mundemi me filluar me investime kapitale, ndërsa me këto shpenzime rrjedhëse dhe punëtorë nuk kemi mundësi para vitit 2019. Ne kemi ardhur në përfundim që mundemi me e votu në parim versionin e projektligjit, ndërsa pjesën tjetër të amendamenteve nuk mundemi për shkak të kostonë së lartë buxhetore.

Bardhyl Meta - ne ishim në takim,aty nuk pat asnjë studim, asnjë koncept. E kam thënë edhe atë ditë që le të vjen ministri këtu në komision dhe le të na tregoj prioritete, dhe jo e më ardh me një projekt që ka filluar në 2012 dhe që ka ndërtuar nëpër dollapa. Ne nuk po i dijmë as detajet lidhur me zbatimin e këtij ligji. Ne bazë të disa studimeve që i kam lexuar me rreth 70 milion euro përmirësohet në total shëndetësia në Kosovë, ndërsa këtu po flitet për 30 milion euro vetëm për një qështje. Pranda, kërkohet një studim apo analizë për nxjerrë koston e saktë të implementimit të ligjit.

Fikrim Damka - ne e kemi diskutuar këtë qështje në grupin punues dhe nuk është që nuk ka ndonjë plan për këtë projektligj. Ne e dimë që emergjencat janë nëpër komuna,disa komuna nuk kanë asnjë autoambulancë, p.sh Dragashi si komunë asnjë autoambulancë se ka dhe është një orë larg qytetit të Prizrenit. Deri sa të shkon autoambulanca atje vdes njeriu. Besoj se me këto ndryshime të komisionit funksional, prioritet ka qenë në fokus njeriu.

Kryetari - në nenin 39, paragrafi 2 thuhet: deri në funksionalizimin e QKSHME-se dhe njësive të saj, shërbimet mjekësore emergjente paraspitalore ofrohen nga QKMF në komunat përkatëse. Nëse kjo nuk organizohet vazhdon me funksionin qysh është, vetëm ndahet nëpër komuna. Nëse nuk ka mjete Qeveria, Ministri i Financave duhet të bisedojë me Ministrin e Shëndetësisë, le të thotë të tërheqë se ligjin se nuk ka me hy në funksion për shkak të mjeteve shtesë buxhetore, por mos të jetë që komisioni jonë po e ndal ligjin, se edhe ashtu nuk mund ta ndalim. Ne duhet të paraqesim rekomandimin tonë, ndërsa senaca vendos.

Bardhyl Meta - ne prapë po flasim prej 15 deri në 30 milion euro dhe nuk ka koncept të punës, nuk e përshkruan ata 400 veta ku kanë me punë, a janë shofera apo mjek të ndihmës se shpejt apo çka janë?

Besa Gaxheri - duke pasur parasysh problemet në shëndetësi, ne si komision i buxhetit, konsideroj që mundemi me ju thanë se paku këtyre dy ministrive pa u marr vesh ju në mes vete që me e sjell këtë kosto buxhetore, ne nuk merremi me të edhe përkundër asaj që mund të vonohet ky ligj në Kuvend.

Safete Hadërgjonaj - ajo çka është me e keqja është se nuk kemi politika shëndetësore për shëndetësinë. Fillojnë me një strategji, vitin tjetër e ndryshojmë, ndërrojnë Qeveria, ndërrojnë politikën e Qeverisë dhe shëndetësinë e kemi në këtë gjendje, që është mjerim. Ne si komision mundemi me dhënë rekomandimin që ka kosto buxhetore që nuk është e planifikuar as KASH, por nuk është as në buxhet dhe le të vendosin deputetet në seancë. Por ne si komision nuk mundemi me e ndal ligjin. I vetmi që mundet me e tërheq ligjin tani është ministri i shëndetësisë. Nëse rekomandojmë që me hy në fuqi ligji në vitin 2019 apo 2020, atëherë nuk kemi bërë asgjë dhe mundemi me marr vërejtje nga Komisioni Evropian dhe institucionet e ndryshme për mos zbatim të ligjit.

Bali Muharremaj - projektligji që ka ardhur fillimisht prej Ministrisë së Shëndetësisë nuk ka kosto që është e papërbalueshme, mirëpo amendamentet e komisionit funksional që e ndryshojnë strukturën e ligjit e që tani po i mbështet ministria, e kanë krijuar koston shtesë që po kushtonë 30 milion euro. Atëherë pse Ministria e Shëndetësisë nuk e ka sjellë në fillim këtë projektligj në këtë formë qfarë është propozuar me amendamentet e komisionit funksional.

Fikrim Damka - komisioni se bashku me ministrin e shëndetësisë janë dakorduar që të ndryshojnë komplet nenet. Për këto ndryshime kemi pasur edhe pëlqimin e Kryeministrit.

Shqipe Pantina - nëse Ministri i Shëndetësisë qenka pajtuar me këto ndryshime që i ka propozuar komisioni funksional, atëherë është edhe përgjegjësi e kësaj ministrie me ra dakord me Ministrinë e Financave se si do të gjenden mjete për zbatimin e këtij ligji. Për me tepër duhet deklaruar si Qeveri, pasi që projektligjet vijnë prej Qeverisë dhe jo prej një ministrie të caktuar. Ose le të tërheqet projektligji, të

bëhen ndryshimet e nevojshme, duke i përfshirë propozimet që janë bërë me amendamente dhe le ta sjellin edhe me pjesën financiare.

Labinotë Demi-Murtezi - si anëtare e grupit punues ka menduar se në takimin që kemi mbajtur e kemi përfunduar këtë punë dhe e kemi lënë me e kryer ministritë në mes vete. Si projekt ky ka qene i mirë dhe i nevojshëm, por ka disa dhjetëra projekte te tjera te nevojshme dhe te domosdoshme për shëndetësin. Aty përveq ndërtimit të qendrës është paraparë një numër i stafit me trajnime të veçanta. Përndryshe ne e bëmë krahasimin atë ditë në grup punues që munden me na mbet këto objekte sikurse që po na mbesin shumë shkolla. Unë i propozova këshilltarit te ministrit qe ta ruaj këtë projekt, nëse për momentin nuk shkon ka me qenë një projekt qe vendit tonë ka me ju dashtë. Unë kam bërë një hulumtim dhe e pashë që Suedia funksionon si shtet me këtë projekt. Ky si projekt është shumë i avancuar dhe i nevojshëm, por që nuk ka buxhet është tjetër gjë.

Enver Hoti - ky projektligj dhe amendamentet që kanë ardhur nga komisioni funksional dhe me përkrahjen e ministrisë po na jep me kuptu se ne nuk jemi të vetëdijshëm se çka posedojmë. Ne posedojmë edhe institucione të tjera qe merren me shërbime emergjente qe janë të organizuara dhe funksionale të cilat mund të vijnë në shprehje. Është për të ardhur keq që as Qeveria as komisioni funksional nuk e ka trajtuar gjendjen e Qendrave të Mjekësisë Familjare se cilat janë shërbimet emergjente. Kemi agjencion të menaxhimit te emergjencave i cili i kontrollon të gjitha qendrat e thirrjeve dhe ka staf të trajnuar. Shërbimet emergjente nuk mund të shkojnë te ndara, kur një aksident aty duhet te implikohet policia, zjarrfikësit, prandaj ky projektligj ka interferim me ligjet tjera. Është totalisht e shturur, sikur që ky komision dhe kjo ministri ka punuar ndaras.

Kryetari – ne kemi dy mundësi për të rekomanduar: Një të rekomandojmë që ka kosto të përballueshme, dhe mendojë që në tri vitet e ardhshme duhet ndarë mjetet për me u funksionalizue ligji. Apo rekomandimi i dytë se ka kosto te papërballueshme zabtimi i këtij ligji, respektivisht amendamentet e komisionit funksional.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi komisioni me pesë vota Për, katër Kundër dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-24 për shërbimin mjekësor emergjent dhe amendamentet e Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, përmbajnë implikime buxhetore shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-110 për kamatvonesën në transaksionet tregtare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktural, Tregti dhe Industri;**

Kryetari – theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë dhe si të tillë propozojë që të procedohet me tutje në komisionin funksional dhe senacën plenare.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-110 për kamatvonesën në transaksionet tregtare dhe amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi se ka pranuar një kërkesë të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane që kanë rekomanduar të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të kthehet Bordi për Rishqyrtimin e Ankesave tatimore dhe doganore si shkallë e dytë në procedurë administrative dhe të themelohet si agjencion i pavarur, me kritere ta zëmë si te Bankës Qendrore. Këtë kompetencë tash për tash e ka Divizioni Fiskal të Gjykatës Themelore, por kjo formë nuk po funksionon si duhet në praktikë. Gjyqtarët meqenëse merren me çështje juridike dhe pak kanë njohuri për problemet e tilla financiare ata po angazhojnë ekspert dhe vlerësimi i ekspertit është përcaktues në marrjen e vendimit. Në kemi informacione që Projektligji për Agjencinë e të Hyrave që parasheh bashkimin e Doganave të Kosovës dhe ATK-së është duke ardhur dhe nëse procedohet mund ta rregullojmë këtë çështje në këtë ligj. Por parapakisht propozojë që të angazhojmë një ekspert që ta bëjë një analizë apo vlerësim për këtë organ dhe pastaj vendosim për mënyrën e rregullimit.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni vendosi për angazhimin një eksperti për përgaditjen e analizës lidhur me funksionalizimin e Organit për shqyrtimin e ankesave tatimore dhe doganore, si organ i shkallës së dytë në procedurën administrative, i cili do të kompensohet nga buxheti i Komisionit.

Kryetari – njoftoi anëtarët e komisionit, që sapo është proceduar nga Qeveria në Kuvend, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Faljen e Borxheve. Në bazë të draftit të projektligjit, Qeveria ka kërkuar me ia zgjat afatin e faljes së borxheve deri me 15 prill 2017, pra është fjala për gjashtë muaj dhe nuk ka asnjë ndryshim tjetër. Mundemi me e kalue sot nëse dojmë me e fut me procedurë të jashtëzakonshme. Mendimi im është që afati të jetë deri më 1 qershor 2017. Propozojë që komisioni ta përkrah në parim Projektligjin dhe ti rekomandojë Kuvendit miratimin në lexim të parë dhe kjo të bëhet në seancën e nesërm, me shmangje të Rregullores.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht përkrahu në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe i rekomandojë Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e tij në lexim të parë, përmes shmangjes së Rregullores së Kuvendit.

Kryetari – propozojë që të formohet një grup punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168. Në grupin punues të jenë Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Shqipe Pantina. Në takimet e grupit punues do të ftohen përfaqësuesit e Trustit Pensional.

Shqipe Pantina - unë jam dakord me grupin punues, por kisha propozuar patjetër me organizue një dëgjim publik. Unë mendoj se duhet me e ftue Trustin, por edhe organizata të ndryshme.

Kryetari - ky ligj ka të bëjë me trustin jo me pensionet. Është e ditur, asnjë institucion nuk guxon me mbajt mjete që nuk i dihet te kujt janë. Nëse ka mjete që nuk dihet te kujt janë, atëherë ato mjete duhet me i identifikue diku tjetër. E drejta nuk i mohohet atij që identifikohet se janë mjete e tij, por Trusti nuk

mundet me i mbajt deri sa nuk identifikohen. Këto mjete është propozuar me i qit ne buxhet. Unë jam i obliguar te mbroj edhe institucionin por edhe te drejtën e atij qe janë mjetet, prandaj duhet me e bërë një amendament, ku do të thuhej se në momentin e identifikimit të titullarit, brenda tre, dy muajve apo një vit, varet si janë proceduar mjete duhet me kthye në llogari të kontributdhënësit të indetifikuar.

Shqipe Pantina - unë jam dakord me diskutu për me e gjete mënyrën më të mirë se qysh me i identifikue kontributdhënësit, megjithatë në bazë të shqetësimeve qe janë ngrit, unë prapë mendoj se duhet me e organizue një lloj dëgjimi publik sepse ne momentin qe shkon ne seancë nuk ka me pas mundësi për sqarime profesionale, dhre gjithë kahja ka me qenë politike. Nëse ne dëshirojmë me i heq dyshimet tek njerëzit për këtë qështje, duhet me organizue një dëgjim publik.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se komisioni unanimisht formoi grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Shqipe Pantina. Grupi Punues përgadit raportin me rekomandime për shqyrtim në komision.

Safete Hadërgjonaj - një çështje qe desha me e ngrit është çështja e punës se komisionit. Ne vitin e kaluar i kemi pasur në plan dy ligje me i monitorue dhe me duket vetëm për Ligjin për Prokurim Publik i kemi analizuar disa rekomandime sa po implementohen, dhe nuk kemi monitoruar asnjë ligj tjetër. Këtë vit kemi në plan të punës që të monitorojmë edhe Ligjin për Partneritetin Publik-Privat. Unë propozojë që të formojmë një grup punues dhe të të bëjmë monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe nxjerr rekomandimet për Kuvendin.

Kryetari - propozojë që të formohet grupi punues për mbikëqryjen e zbatimit të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat dhe propozojë që në grup punues të jenë: Safete Hadërgjonaj (kryesuese), Besa Gaxherri, Enver Hoti, dhe Labinotë Demi-Murtezi.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht formoi grupin punues për mbikëqryjen e zbatimit të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat, me këtë përbërje: Safete Hadërgjonaj (kryesuese), Besa Gaxherri, Enver Hoti, dhe Labinotë Demi-Murtezi.

Bardhyl Meta - unë edhe në mbledhjen e kaluar, kam propozuar me organizuar një punëtori tre ditore, dhe të bëjmë një plan pune për qështjen që do të merremi si komision. Të analizojmë gjendjen e ndërmarrjeve publike dhe të nxjerrim rekomandime konkrete, pasi që për shmebull te rasti i Valës, çdo dite drejtori i valës ka dhënë intervista qe ajo ndërmarrje është duke shkuar ne falimentim dhe të jeni të bindur që vitin tjetër ne kemi e nda mjete buxhet për këtë ndërmarrje. E dyta të analizojmë qështjen e kontratave mbi vepër ne nivel të komunave dhe nivel të qeverisë. Të bëjmë një analizë sa janë këtë kontrata mbi vepër, sa milion po bëjnë edhe me të nxjerrim. Mandej qështje tjetër është qiraja që paguajnë institucionet për objektet që i shfrytëzojnë. Për të gjitha këto qështje të nxjerrim rekomandime për Qeverinë dhe Kuvendin.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani